

VENDIM
Nr. 4, datë 6.2.2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 5, DATË 2.4.2019, TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, “PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229 dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 5, datë 2.4.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, bëhen këto shtesa dhe ndryshime :

1. Pas pikës 14, shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Nëse Këshilli zbulon rrethana ose prova të reja me shkresë, që kanë rëndësi për lejimin e kandidimit, të cilat nuk dihen dhe nuk mund të dihen gjatë zhvillimit të procedurës administrative të verifikimit, atëherë procedon me rishikimin e vendimit të lejimit”.

2. Në pikën 39, pas fjalëve “procedurave të verifikimit” shtohen fjalët “dhe pasi të jetë siguruar që vendimi i lejimit të jetë arsyetuar dhe njoftuar rregullisht çdo kandidat”.

3. Pas pikës 39, shtohet pika 39/1, me këtë përmbajtje:

“39/1. Kur procedura e verifikimit përfundon në fund të vitit kalendarik, atëherë afati i përcaktuar në pikën 39 është jo më vonë se 3 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit të radhës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ardian Dvorani